



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

'Koka bën, koka pëson, Rama batuta në banorin që lu shemb ndërtimi na

leje në Theth: Magjinë e prish zhvillimi i pakontrolluar, 'Zvicrën e vogël' e keni këtu (VIDEO)
- 2

Nata e 10 e sulmeve, SHBA godet komandat iraniane! Irani sulmon bazat ushtarake amerikane në Bahrein e Kuvajti! Houthi: Bllokojmë ngushticën Bab El Mandeb
- 3

SHBA i vendos tarifë doganore 50% Kanadasë, vlera e produkteve të prekura arrin gati 20 miliardë dollarë! Hyjnë në fuqi pas 30 ditësh
- 4

Donaldi me shenja në trup, Bora na zbulon arsyen
- 5

'Disa ditë më vonë, kur ajo hyri në ambientin e tij të punës për ta takuar sërish, Mbreti Zog i la të gjitha', libri i gazetares franceze, për Mbretëreshën Geraldinë Appony

Kronikë

Tritol në shtëpinë e vëllait të Julian Ballës në Shijak, dyshime për kërcënim! I përfshirë në organizatën e Çopjave, ish-presidenti i klubit ‘Erzeni’ ende në kërkim nga SPAK

Julian Balla është në kërkim prej një viti nga SPAK pasi ndaj tij ka masë sigurie “arrest me burg” pas operacionit të Prokurorisë që goditi organizatën kriminale të Çopjave e Çelajve në Elbasan.



Julian Balla dhe 'Ajman Park'

Redaksia

21 Korrik, 08:56 | Përditësimi: 21 Korrik, 09:55

Share

Post

WhatsApp

A A

Një sasi tritoli ka shpërthyer në portën e shtëpisë së Altin Balles, vëllai i Julian Ballës në **Shijak**. Ky i fundit është në kërkim prej një viti nga SPAK pasi ndaj tij ka **masë sigurie** “arrest me burg” pas **operacionit të Prokurorisë** që goditi organizatën kriminale të Çopjave e Çelajve në Elbasan.

Nga shpërthimi nuk ka pasur të lënduar, por vetëm dëme materiale dhe ngjarja ka ndodhur të shtunën, (17 korrik). Dëmet kanë qenë të vogla. Ende nuk ka një autor nga ana e policisë. Sasia e tritolit është vënë në derën e shtëpisë së Altin Ballës në zonën e Shijakut, e cila ndodhet ngjitur me atë të vëllait, Fadilit. Hetuesit thonë se vendosja e lëndës shpërthyes duket më shumë si një mesazh kërcënues.

Julian Balla është pronar i resortit "Ajman Park", ku përfshihen hotele, godina shërbimi, restorant dhe ambiente tregtare, në **Xhafzotaj, Durrës**, dhe i vilës dykatëshe “ELYSIAN”, në bregdetin e Dhërmiut, bashkia Himarë (sipërfaqe totale rreth 378.2 m²), me vlerë tregu prej afërsisht 1.000.000 Euro, të cilat janë sekuestruar nga **SPAK**. Julian Balla është edhe ish-president i skuadrës së “Erzenit”.



LEXO EDHE: 'Jo vetëm trafik kokaine', media ekuadoriane: Mafia shqiptare e përfshirë edhe në vjedhje dhe kontrabandë nafte

Në operacionin e SPAK në gusht të vitit të shkuar rezultoi se grupi i Çopjave ka trafikuar nga Amerika Latine në Evropë 28 ton kokainë në 2 episode të ndryshme, nga të cilat 17 ton u sekuestruan.

Franc Çopja bashkëpunonte me Ervis Çelën, i cili bashkë me vëllain, siguronin kokainën nga prodhuesit. Droga magazinohet dhe bëhej gati për transport në Paraguai dhe më pas fshihej në produkte të ndryshme. Kontejnerët i sillnin në rrugë detare nga Amerika e Jugut në Belgjikë e Gjermani nga ku më pas shpërndareshin.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

P.J./S.I.E./Shqiptarja.com

TAG: julian balla spak Franc Çopja trafik droge dosja e vëllezërve Çopja Durrës shijak xhafzotaj

Komento

Komente



Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës: Territoriaja, si e vlerësoni propozimin e PS për më pak bashki dhe ndarje në rajone?

20 Korrik, 07:09

I drejtë I gabuar Nuk e di

Lajme të tjera



VIDEO/ Si vidheshin paratë në postën e Durrësit, ish-shefja e Financës lëviz paratë me thasë të zinj

21 Korrik, 15:08



Sherr për zhurmat, stafi i një resorti në Golem dhunon 5 turistët turq! Në pranga menaxheri dhe një punonjësi i plazhit, 2 të tjerë në hetim

21 Korrik, 11:12



Gjyqi në GJKKO pa Veliain e Xoxën, Ndreca mungon, gjobitet me 50 mijë lekë! Valentina Teodoresku caktohet avokate kryesisht, seanca shtyhet më 15 shtator



Keti Banushi

21 Korrik, 09:40



Kërkon identifikimin dhe ndjekjen penale të Nesti Angonit, GJKKO do të shqyrtojë kërkesën e Erion Veliajt! Prokuroria e Tiranës nuk e gjeti personazhin anonim

20 Korrik, 19:42



Shkelja me tenderin 700 mijë euro, GJKKO pranon gjykimin e shkurtuar për kryebashkiakun e Shkodrës dhe 5 të pandehur të tjerë



Keti Banushi

20 Korrik, 16:28



Gjyqi/ Berisha mbron aferën Partizani: S'kam nevojë për dëshmitarë pro meje, s'ka pasur asnjë shkelje ligjore

20 Korrik, 11:19



‘S’do t’i bënte mirë bashkëshortes’, trafikanti shqiptar i drogës i shpëton dëbimit nga Britania e Madhe: Ka rol kritik, siguron pastrim e gatim (EMRI)

19 Korrik, 18:49



Do bënin kontroll në resort, administratori dhe 4 punonjësit marrin peng inspektorët e Tatimeve! Arrestohen nga policia (EMRAT)

19 Korrik, 11:58



Zbulohet bazë me armë e municion luftarak në Durrës, arrestohet 20-vjeçari! Furnizonte grupet kriminale (VIDEO)

19 Korrik, 10:03




U arrestua për vjedhjen e 700 mijë € në Postën e Durrësit, zbardhet dëshmia e ish-drejtoreshës: Si u përplasa me Valbona Dunin, transportonte paratë pa mjet të blinduar! Ja urdhri që dhashë

18 Korrik, 17:46



Gjykata la në burg ish-drejtoreshën e filialit të Postës së Durrësit, avokati: Vendim absurd, nuk ka prova që i ka marrë ajo lekët

18 Korrik, 15:07



Mbi 700 mijë € u vodhën në Postën e Durrësit, në burg ish-drejtoresha Mataj! Prokurori: Dyshohet se luante bixhoz! Paratë futeshin me thasë në zyrën e saj



Artur Korriku

18 Korrik, 11:49



× [Shqiptarja.com] Lajmi i fundit

'Saliu i solli nga veriu në Bathore', Beqiri shpërthen me akuza: Shkaktari i problemeve me pronat është ai

21 Korrik, 19:00



×

[Sh]

.com

Lajmi i fundit



'Saliu i solli nga veriu në Bathore',
Beqiri shpërthen me akuza:
Shkaktari i problemeve me pronat
është ai

21 Korrik, 19:00